

VENDIM
Nr. 619, datë 30.7.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “BLLOKU I KUFIZUAR NGA RRUGËT ‘MERSIN JAKUPI’, ‘17 NËNTORI’, ‘GJERGJ MEHMETI’, ‘SPARTAK DELIU’, ‘BESNIK HIDRI’, ‘PRINC VIDI’, ‘NIKOLLA IVANAJ’, BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Blloku i kufizuar nga rrugët ‘Mersin Jakupi’, ‘17 Nëntori’, ‘Gjergj Mehmeti’, ‘Spartak Deliu’, ‘Besnik Hidri’, ‘Princ Vidi’, ‘Nikolla Ivanaj’, Bashkia Tiranë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 4 534 940.50 (katër milionë e pesëqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e dyzet pikë pesëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 4 534 940.50 (katër milionë e pesëqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e dyzet pikë pesëdhjetë) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Bashkia Tiranë, pas miratimit të këtij vendimi, aplikon menjëherë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, e cila, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të vendimit, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, si dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA SHPRONËSIMI PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “BLLOKU I KUFIZUAR NGA RRUGËT ‘MERSIN JAKUPI’, ‘17 NËNTORI’, ‘GJERGJ MEHMETI’, ‘SPARTAK DELIU’, ‘BESNIK HIDRI’, ‘PRINC VIDI’, ‘NIKOLLA IVANAJ’, BASHKIA TIRANË”

NR.	Pronari			Të dhëna kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)									Vlerësimet për shpronësim							Shënime
	Emër	Atësia	Mbiemër	Qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Vol.	Faqe	“Truall”			“Ndërtesë”			Vlera totale (lekë)	
													Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	Petrit	Dali	Vladi	Tiranë	8320	3/1151	Truall	385	385	67.2	17	115	2.60	22,985.00	59,761.00				59,761.00	
2	Ismet Halil Flamur	Sulajman Sulajman Sulejman	Mena Mena Mena	Tiranë	8320	3/103	Truall	339.5	339.5	103.9	19	193	3.80	22,985.00	87,343.00				87,343.00	
3	Enver	Iljaz	Tota	Tiranë	8320	3/102	Truall	355	355	89.1	19	192	4.20	22,985.00	96,537.00				96,537.00	
4	Naim	Adem	Kojku	Tiranë	8320	3/785	Truall	206.8	206.8	87.5	16	26	4.60	22,985.00	105,731.00				105,731.00	
5	Mehmet	Hysen	Sheta	Tiranë	8320	3/428	Truall	297.5	297.5	0	3	26	60.10	22,985.00	1,381,398.50				1,381,398.50	
6	Rexhep	Hysen	Sheta	Tiranë	8320	3/1683	Truall	288	288	0	38	77	2.30	22,985.00	52,865.50				52,865.50	
7	Bedrije Muharrem Bajram	Ali Mustafa Mustafa	Ferhati Ferhati Ferhati	Tiranë	8320	3/426	Truall	595	595	0	3	24	98.10	22,985.00	2,254,828.50				2,254,828.50	
8	Ardian	Pelivan	Resulaj	Tiranë	8320	3/449	Truall	306	306	92	4	50	1.80	22,985.00	41,373.00				41,373.00	
9	Bashkim	Kadri	Visha	Tiranë	8320	3/1428	Truall	500	500	108.4	23	208	17.30	22,985.00	397,640.50				397,640.50	
10	Fatbardh	Shyqyri	Myftaraj	Tiranë	8320	3/1660	Truall	400	400	83.6	36	74	2.50	22,985.00	57,462.50				57,462.50	
VLERA TOTALE																			4,534,940.50	